

Në përgjigje të shkresës suaj të datës 04.03.2026, protokolluar me tonën nr. 1349 prot., datë 5.03.2026, përmes së cilës keni kërkuar informacion në lidhje me procedurat administrative që duhet të ndjekë një institucion publik, në rastet e testimit të kandidatëve përkatës, nëpërmjet përdorimit të programeve kompjuterike (platforma elektronike testimi), Departamenti i Administratës Publike (DAP) ju sqaron si më poshtë vijon:

*Së pari*, në zbatim të pikës 1 (f), të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, DAP është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore. Sipas pikës 1 (a) të po këtij neni, përcaktohet se “institucion i administratës shtetërore” është aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit. Ndërkohë, për institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësi përgjegjëse është njësia e burimeve njerëzore.

*Së dyti*, në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, DAP-i ka këto detyra:

- a) përgatit dhe mbikëqyr zbatimin e politikave shtetërore në shërbimin civil;
- b) përgatit projektaktet ligjore dhe nënligjore për shërbimin civil;
- c) mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;
- ç) përgatit mendim për çdo projekt-akt të propozuar nga institucionet e tjera që ka të bëjë me marrëdhëniet e punësimit në administratën publike;
- d) miraton dhe ndjek zbatimin e programeve të trajnimit në shërbimin civil;
- dh) përgatit planin vjetor të pranimit për institucionet e administratës shtetërore;
- e) përfaqëson, së bashku me Ministrinë e Financave, Këshillin e Ministrave në negociatat dhe konsultimet për kushtet e përgjithshme të punës në shërbimin civil me sindikatat ose përfaqësuesit e nëpunësve civilë;
- ë) administron Regjistrin Qendror të Personelit;
- f) mbështet dhe siguron këshillimin e institucioneve në zbatim të këtij ligji;
- g) përgatit udhëzime të përgjithshme dhe manuale për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;
- gj) i paraqet Kryeministrit, me propozim të institucioneve të administratës shtetërore, strukturën dhe organikën e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë;
- h) në përputhje me legjislacionin në fuqi, harton dhe bashkëpunon për strukturën e pagave për nëpunësit dhe punonjësit e administratës publike, qendrore dhe vendore;
- h/1) harton dhe miraton rekomandimet për politikën e trajnimeve të nëpunësve civilë.
- i) ushtron çdo kompetencë të dhënë nga ky ligj apo në bazë të tij.

*Së treti*, DAP zhvillon procedurat e konkurrimit për pozicionet vakante në institucionet e administratës shtetërore, në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Në këto procedura, testimi me shkrim organizohet në format fizik (letër), nëpërmjet testeve të strukturuar me alternativa (multiple choice), të cilat plotësohen nga kandidatët në formë të shkruar gjatë zhvillimit të procesit të testimit. Vlerësimi i përgjigjeve të kandidatëve realizohet nëpërmjet një sistemi të kompjuterizuar (OMR) në fazën

e korigjimit dhe llogaritjes së rezultateve. DAP nuk përdor platforma elektronike testimi apo programe kompjuterike për zhvillimin e testimit, administrimin e tij në mënyrë elektronike, apo monitorimin e veprimtarisë së kandidatëve në kompjuter gjatë procesit të konkurrimit.

Për rrjedhojë, DAP nuk disponon praktika administrative apo rregullime procedurale lidhur me organizimin e testeve nëpërmjet platformave elektronike. Në këto kushte, si dhe referuar detyrave të parashikuara në nenin 7, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, DAP-i nuk është organi kompetent për trajtimin e kërkesave tuaja.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,